

**AKT THEMELIMI DHE STATUT  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“ZEJDI.AL” SH.P.K.**

**KREUI**

**Dispozita të Përgjithshme**

**Neni 1**

**Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “ZEJDI.AL” SH.P.K .** themelohet ne perputhje me ligjin 9901 date 14.04.2008”Per Tregtaret dhe ShoqeriteTregtare” si dhe ligjit nr.9723 dt.03.05.2007 per “Qendren Kombetare te Kombetare te Biznesit”

Sot, më **22/05/2023** ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “ZEJDI.AL” SH.P.K.

**Shoqeria themelohet nga 1 (një) ortak.**

**Z.Algert Spahiu**, lindur në Bulqize , më 19/03/1991 ,banues në Rr.Ilia Llavda 00690350; Nd. 9; H. 1; Durres i indetifikuar me ID JI0319009C

**Neni 2**

Emërtimi i shoqërisë është “ZEJDI.AL” SH.P.K.

**Neni 3:**


Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për nje afat te pa përcaktuar.

**Neni 4**

Shoqëria e përcaktuar në nenin 1 të këtij statute krijohet me mjete private të themeluesve të saj

**Neni 5**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “ZEJDI.AL” SH.P.K.



Në përputhje me krijimin e kësaj shoqërie dhe me legjislacionin shqiptar, rregullon pozitën juridike të themeluesve dhe të punonjësve në shoqëri, të dhënat me rëndësi për qarkullimin juridik, organizimin, objektin e veprimtarisë dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e shoqërisë.

#### **Neni 6**

Shoqëria "ZEJDI.AL" SHPK është person juridik shqiptar dhe fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit në organet përkatëse. Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e parashikuara në dokumentat e krijimit të saj, kontratën dhe në këtë statut.

#### **Neni 7**

Shoqëria do të kryejë aktivitetet me objekt:

Ofrimin e shërbimeve në fushën e bareve, restoranteve, hotelerisë, turizmit, tregtimit në çfarëdo forme të mjetëve të luajtshme të reja dhe të përdorura, përfshirë importin dhe eksportin, të autovekurave, motocikletave, autokarro, barka, automjetet edhe autovekura në përgjithësi; Shërbimii qirase dhe nënqirase përvend edhe jashtë shtetit, të mjetëve të luajtshme të reja dhe të përdorura si automjete dhe autovekura, në përgjithësi me dhe pa shofer.

Shërbime ndërmjetësimi për të gjitha llojet e aktivitetëve të shoqërive tregtare dhe të turizmit në përgjithësi. Import eksport të mallrave industriale të reja dhe përdorura.

#### **Neni 8**

Selia e shoqërisë "ZEJDI.AL" Sh.P.K.

Lagja nr. 13, Plazh, të ndodhur në ZK 8518, nr. pasurie 39/34 Durrës.

#### **Neni 9**

Shoqëria ushtron veprimtarinë e vetë të përcaktuar në këtë statut në territorin e Republikës së Shqipërisë. Për kryerjen e kësaj veprimtarie shoqëria mund të çelë degë, filiale dhe zyra të saja të përfaqësimit brenda dhe jashtë vendit në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe të vendit ku është hapur.

#### **Neni 10**

Shoqëria kryen veprimtarinë e saj për të realizuar fitimin e saj duke u mbështetur në parimet e likuiditetit, sigurisë dhe rentabilitetit.

#### **Neni 11**

Pjesëmarrja në shoqëri nuk i pengon ortakët e të kenë pavarësi ligjore për veprimtari të tjera e për të drejta të tjera pronësie.

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë që rrjedhin nga objekti i veprimtarisë së saj tek kapitali themeltar.



## Neni 12

Të drejta kryesore të ortakeve janë:

1. Pjesëmarrja në administrimin e veprimtarisë së shoqërisë më përputhje me kontratën dhe statutin e vet ose nëpërmjet përfaqësuesve të tij.
2. Pjesëmarrja në rezultatet e veprimtarisë së shoqërisë në çdo formë dhe sasi qoftë në përputhje me statutin dhe kontratën.
3. Pjesëmarrja në organet e shoqërisë që janë ose mund të krijohen nëpërmjet përfaqësuesit të tij ose vetë.
4. Të kërkojë t'i jepen të gjitha informatat që kanë të bëjnë me gjendjen tregtare të shoqërisë si dhe të gjitha dokumentet e përpunuara të shoqërisë si bilanci, llogaritë ekonomike etj.
5. Të bëjë propozime dhe t'i paraqesë ato për shqyrtim para organeve të shoqërisë.
6. Të emerohet dhe të shkakrohet përfaqësuesit e saj, punonjësit, ekspertin kontabël dhe likuidatorët.

## Neni 13

Detyrimet e ortakeve janë:

1. Pjesëmarrje në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara prej tij, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve që krijon ai.
2. T'i japë shoqërisë informacionet e nevojshme që kanë të bëjnë me ecurinë e veprimtarisë së saj
3. Të kryejë shërbimet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe realizimin e funksioneve të saj.

## KREU II

### Kapitali i Regjistruar

#### Neni 14

Veprimtaria e shoqërisë realizohet në bazë të veprimtarisë kontabël dhe pasqyrohet në bilancin e saj

#### Neni 15

Kapitali themeltar i kësaj shoqërie është 100.000 (njëqindmije ) lekë,  
Sasia e kuotave është 1, me vlerë nominale 100.000 leke

Kapitali i shoqërisë zotërohet si me poshtë :

Z. Algert Spahiu 100% të kapitalit të shoqërisë

#### Neni 16

Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar nëpërmjet shtimit të pjesëve të saj, ortakët e shoqërisë kanë të drejtën e rritjes në mënyrë proporcionale.

#### Neni 17

Pjesët e kapitalit themeltar janë plotësisht të transferueshme në rrugë trashëgimie në rast ndarje pasurie ndërmjet bashkëshortëve, parardhësve dhe pasardhësve. Transferimi duhet të vërtetohet me akt noterial.



### **Neni 18**

Shoqëria në emër të vetë është pronare, përdoruese dhe disponuese e pasurive të saj gjithmonë në përputhje me qëllimin e objektit të veprimtarisë që ajo kryen. Shoqëria mund të shesë pasuri ose të shfrytëzojë të drejta të tjera materiale. Ajo mund të ofrojë për garanci dhe pasuri të saj për të marrë kredi bankare.

### **Neni 19**

Shoqëria krijon fonde rezervë ose fonde të tjera të veçanta për zhvillimin dhe nxitjen ekonomike të saj.

Shoqëria disponon mjetet e veta financiare. Detyrimet eventuale që mund të lindin gjatë veprimtarisë së saj mbulohen nga fondet rezervë, fondet e tjera ose nga shumat themeltare që kur dëshirojnë mund të derdhen prej ortakut të vetëm, në rastet kur këto detyrime nuk mund të mbulohen nga fondet ekzistuese.

## **KREU III**

### **Viti Financiar, Llogaritë Vjetore, Ndarja e Fitimit**

#### **Neni 20**

Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor. Përrjashtimisht viti i parë financiar ka filluar në ditën e regjistrimit të shoqërisë dhe përfundon me 31 Dhjetor të atij viti.

#### **Neni 21**

Pasqyrat Financiare vjetore të shoqërisë deklarohen brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës.

#### **Neni 22**

Ortaku e përballon vetë humbjen e veprimtarisë së shoqërisë në të ardhmen.

#### **Neni 23**

Llogaritë vjetore, inventari, raportet, operacionet e citit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabël i autorizuar miratohen nga ortaku i shoqërisë. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.


#### **Neni 24**

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria, pas zbritjes së të gjitha detyrimeve si dhe fondet e lëna për rezervë për nxitje ekonomike, për investime, për reklamën tregtare etj e përfitojne 100% ortakët e shoqërisë.

## **KREU IV**

### **Administrimi**

#### **Neni 25**



Asambleja thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Asambleja mbledhet në rastet e përcaktuara nga Ligji nr.9901 , nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë sipas kërkesave të nenit 82, pika 2 e ligjit nr. 9901. Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të këtij ligji, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare “, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.


Administrimi i shoqërisë bëhet nga administratori.

1. Asambleja emeron administratorin për një periudhë 5 (pesë) vjeçare sipas parashikimeve të shkronjës ‘c’ të pikës 1 të nenit 81 dhe të nenit 95 të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” . Emërimi do të jetë individual dhe sipas një vendimi të marrë me shumicë të zakonshme nga Asambleja .
2. Kufizimet në lidhje me emërimin e Administratorëve prashikohen në pikën 2 të nenit 95 të Ligjit.
3. **Z. Algert Spahiu caktohet si administrator i shoqërisë.**

### Neni 26

Kompetencat e Administratorit janë:

1. Miratimi i planeve dhe llogarive ekonomike pas përpunimit të tyre në kuadër të veprimtarisë së shoqërisë.
2. Të bëjë propozimet e nevojshme në mbledhjet e asamblesë, kur lind nevoja e ndryshimit të kapitalit themeltar.
3. Miratimi i akteve normative që përcaktojnë raportet gjatë e shoqërisë duke përfshirë kuadrin dhe personelin.
4. Përcaktimi i strukturës së aparatit të shoqërisë



5. Krijimi i organeve të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të shoqërisë.
6. Propozimi në mbledhjet e asamblesë për krijimin e njësisë, strukturave, filialeve, degëve dhe përfaqësive në qytet të tjera të vendit apo jashtë shtetit.
7. Përzgjedhja e Ekspertit Kontabël dhe anëtarëve të komisionit të likuidimit dhe paraqitja e propozimeve për miratim në asamble.

## KREU V

### **Prishja dhe Njoftimet**

#### **Neni 27**

Kontrolli i shoqërisë mund të kryhet nga një Ekspert Kontabël i Autorizuar për tre vite financiare me mundësi rizgjedhje. Ai caktohet nga ortaku i shoqërisë. Shkarkimi i Ekspertit Kontabël të Autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emërimi, ose kur bëhet e pamundur kryerja e detyrave.

#### **Neni 28**

Në rast likuidimi të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe Vendimin e marrë nga Asambleja e Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qellim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis ortakëve të shoqërisë.

## KREU VI

### **Dispozita të fundit**

#### **Neni 29**

Ku statut së bashku me ndryshimet dhe të gjitha dokumentet e tjera, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhëna nga shoqëria do të mbahen në një libër të veçantë që mbahet në selinë e shoqërisë.

## **ORTAKU I SHOQERISE**

**“ZEJDI.AL” SH.P.K.**

**Algert Spahiu**

*Algert Spahiu.*  
